



Republika e Kosovës
Republik of Kosova
Republika Kosovo



Komuna e Vitisë
Municipality of Vitina
Opstina Vitina

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-068, për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës neni 5 pika d, neni 35 pika 1.të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, dhe të Udhëzimit administrativ të MASHT-it, nr.08/14 të dt.25.02.2014,për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes drejtorëve dhe të zv.drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese,Drejtoria e Arsimit shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në institucionet edukativo-arsimore

- Drejtor shkolle në **Shf,,Nazmi Pajaziti''**në Radivojcë,
- Drejtor shkolle në **Shf,,Kenan Halimi''**në Gjylekar,
- Drejtor shkolle në **Shf,,Ndre Mjeda''**në Kabash,
- Drejtor shkolle në **Shf,,Ahmet Hajdari''**në Beguncë,

Kushtet :që duhet ti plotësojnë kandidatët që konkurojnë në këtë konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/ 4 vite të shkollimit univerzitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore.
- Të kenë licencë të rregulltë të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedur të licencimit.
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menagjim.
- Të kenë më së paku 3-vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Kandidatët duhet të posedojnë-dorëzojnë këto dokumente:

- Çertifikatën e lindjes
 - Diplomën e fakultetit të kryer për nivelinë përkatës
 - Dëshminë për përvojën e punës
 - Portfolion profesionale (shih shtojcën G).
 - Letër reference nga një institucion publik – kredibil (Ministria e arsimit shkencës dhe teknologjisë,DKA, këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë).
 - Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake.
 - Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkuruar (së paku 10 faqe tekst me hapsirë 1.5, fonti i shkronjave me 12, arial) sipas udhëzimit të MASHT.
 - Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetsor publik me të cilën dëshmohet gjendja e tij / saj shëndetësore.
 - Dëshminë se nuk është nën hetime.
 - Kopjen e letërnjoftimit.
 - Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegje private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurojnë për këtë pozitë duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ nr.8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të rrefuzoj ç'do aplikacion të kandidatëve të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit.
 - Kandidatët e interesuar aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Drejtorin Komunal të arsimit në Viti.
- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.
Dokumentet e pa kompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Më: 24.01.2018.Viti

Drejtoria e Arsimit

